

Në bazë të nenit 10 paragrafi (1) dhe paragrafi (6) të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 18-të mbajtur më 23.04.2024, në lidhje me Propozimin nr.03-2009/1 datë 23.04.2024 për iniciimin e procedurës për kundërvajtje kundër SHTR „KLAN MAQEDONI“ SHPKNJP eksport-import – Saraj, Shkup për shkelje të nenit 75 paragrafi (1), dhe në lidhje me nenin 75 paragrafi (4) nënparagrafi 1 të Kodit Zgjedhor, miratoi si vijon:

KONKLuzion

1. Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer (monitorim) mbi përfaqësimin mediatik zgjedhor nr.10-2007/1 datë 23.04.2024 të SHTR „KLAN MAQEDONI“ SHPKNJP eksport-import – Saraj, Shkup përcaktoi shkelje të nenit 75 paragrafi (1), dhe në lidhje me nenin 75 paragrafi (4) nënparagrafi 1 të Kodit Zgjedhor.

2. Këshilli konkludoi kundër SHTR „KLAN MAQEDONI“ SHPKNJP EKSPORT-IMPORT – SARAJ, SHKUP të iniciojë procedurë për kundërvajtje para gjykatës kompetente, pasi nga mbikëqyrja u konstatua se në kundërshtim me nenin 75 paragrafi (1), dhe në lidhje me nenin 75 paragrafi (4) nënparagrafi 1 të Kodit Zgjedhor, në periudhën nga data 4 deri më 22 prill 2024, televizioni nuk ka ofruar (siguruar) informim për procesin zgjedhor në format të aksesueshëm për personat me pengesa, gjegjësisht duke shfytëzuar gjuhën e shenjave, titrat, përshkrim të zërit apo mjeteve të tjera për të siguruar akses, as edhe në të paktën një edicion të lajmeve në bazë ditore, as edhe në përmbajtje të tjera programore në bazë javore të transmetuar në periudhën nga ora 16:00 deri në ora 24:00, gjatë kohës së fushatës zgjedhore në rrethin e parë të zgjedhjeve presidenciale, edhe pse publikonte reklamim të paguar politik vazhdimisht gjatë fushatës zgjedhore.

3. Detyrohet Sektori për çështje juridike të përgatisë Kërkesën për iniciimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente për transmetuesin në fjalë.

4. Kopje e Konkluzionit duhet t'i dorëzohet:

- Udhëheqësve të të gjithë sektorëve të Agjencisë;
- Personit të emëruar nga Agjencia, për udhëheqjen e lëndëve sipas procedurës administrative;
- Njesisë për mbështetjen e punës së Këshillit të Agjencisë;
- Sektorit për mbështetje informatike dhe i punëve të përgjithëshme – Arkivi i Agjencisë.

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.